

VENDIM
Nr. 775, datë 12.12.2022

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 2.3.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT, MBIKËQYRJES DHE
KOLAUDIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘PICAR’, BASHKIA VORË, DHE
CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 122, datë 2.3.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, edhe në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.”.

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku